

Relacion Teknik

**DOKUMENTACIONI PER MBROJTJEN NGA
ZJARRI DHE SHPETIMIN**

**Kopesht-Cerdhe e Integruar
Rr. " Muharrem Caushi", n.j str KA/208
TIRANE**

PERMBAJTJA

1.1 MBESHTETJA LIGJORE DHE NORMATIVE	3
1.2 PJESE E RELACIONIT TE PROJEKTIT MEKANIK DHE HIDRIK TE MNZSH-SE	3
1.2.1 Hidrantet e brendshemt	4
1.2.2 Grupi i pompimit te impjantit kunder zjarrit	4
1.2.3 Sasia e ujit.....	4
1.2.4 Grupi i lidhjes me brigadat MKZ	5
1.2.5 Fikesit portabel te zjarrit	5
1.3 PJESE E RELACIONIT TE PROJEKTIT ELEKTRIK TE MNZSH-SE	6
1.4 SKEMAT E EVAKUIMIT	7

1.1 MBESHETJA LIGJORE DHE NORMATIVE

Projekti per Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpetimin i objektit “Kopesht-Cerdhe e Integruar no.42”, Tirane eshte realizuar ne baze te standarteve dhe normave lokale si dhe ato te vendeve te Komunitetit European. Sistemi i mbrojtjes kunder zjarrit respekton te gjitha kerkesat e detyrueshme shteterore qe kane te bejne me normat / standartet qe jane ne fuqi aktualisht ne Shqiperi si dhe normat Europiane.

Ligjet, rregulloret, normat dhe standartet e perdorura ne kete projekt jane paraqitur ne vijim:

- Ligji nr. 152/2015 “Per sherbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpetimit”;
- Vendimin VKM nr. 319, date 12.04.2017 “Per miratimin e standarteve te projektimit te shkollave”;
- Vendimin VKM nr. 159, date 1.34.2017 “Per miratimin e standarteve te projektimit te kopshteve”;
- Rregullore “Mbi masat e mbrojtjes kunder zjarrit ne projektimin e ndertesave te cdo lloji “Vendim nr.162 date 19.4.1965, e ripunuar;
- Udhhezim i Ministrimit te Puneve te Brendeshme nr.425 date 24.7.2015 “Per pranimin, administrimin e dokumentacionit teknik dhe grafik te projektit te mbrojtjes nga zjarri dhe per shpetimin dhe leshimin e akteve teknike”;
- EN 13501 Fire classifications of construction products and building elements (all parts)
- EN 1838 Lighting applications – Emergency lighting
- EN 1366 Fire resistance tests for service installations
- EN 3-7: Portable fire extinguishers. Characteristics, performance requirements and tests.
- BS EN B2: Fire Safety – Buildings other than Dwell ringing houses – Volume 2

1.2 PJESE E RELACIONIT TE PROJEKTIT MEKANIK DHE HIDRIK TE MNZSH-SE

Ne objektin “Kopesht-Cerdhe e Integruar no.42” Tirane shkalla e rrezikut ndaj zjarrit eshte e njejte, nivel i ulet. Edhe kategoria e zjarreve te hamendesuara eshte po ashtu e njejte, pasi kudo ne keto ambiente zjarret do te jene kryesisht te klases “A” dhe te klases “E” (kategorite materiale te ngurte te djegeshme dhe instalime dhe pajisje elektrike).

Ne teresi, duke marre ne konsiderate edhe karakteristikat e ndertesave si dhe destinacionin e saj, jane perdorur substanca shuarese si me poshte :

- sistem i mbrojtjes nga zjarri me uje, me hidrante te brendshem ne te tre katet e godines;
- shuares portabel ne te gjitha pozicionet e treguara ne projekt.

1.2.1 Hidrantet e brendshemt

Ne te tre katet e godines jane vendosur hidrante te brendshem UNI 25, te pajisur me tubacion “gjysem te ngurte”. Kasetat e hidranteve te brendshem jane vendosur ne pozicion te dukshem dhe e pajisur me sinjalistiken perkatese. Leshuesi dhe tubacioni i ujit jane vazhdimisht te lidhura me kolonat e furnizimit me uje.

Hidrantet do te jene te perbere nga:

- rubinet hidranti prej bronxi UNI 25 me permase 1” (UNI 811);
- tubacion i hidrantit, norma UNI 9488 me riveshje te jashtme rezine poliuretane konsumimit me permase 25mm dhe gjatesi 25m, presion pune >2bar;
- 3 rakorde te zinkuara UNI 804 dhe 811 per lidhjen me tubacionin dhe hedhesin;
- hedhes bakri me lidhje te zhvidoseshme dhe te ndueshme tunxhi UNI 841, guarnicion UNI 8478; manikotat do te fiksohen tek tubi me kapese celiku te zinkuar.

1.2.2 Grupi i pompimit te impjantit kunder zjarrit

Grupi i pompimit te impjantit kunder zjarrit do te vendoset ne godinen e ambientit teknik, ne te njejtin nivel me depoziten e ujit MNZ. Ky grup do te jete ne perputhje me normativen EN 12845 dhe do te perbehet nga 1 pompe pilote, 1 elektropompe sherbimi si edhe motopompa e sherbimit ne perputhje me Vendimin VKM nr. 319, date 12.04.2017.

Ne raste zjarri, me renjen e presionit ne rrjetin kunder zjarrit nen nje nivel te caktuar, kontrollori elektronik do te aktivizojte automatikisht pompen elektrike te sherbimit si edhe te transmetojte nje sinjal zjarri ne sinjalizuesit vizuale. Ne rast se pompa elektrike e sherbimit nuk staron per cfaredo arsye, motopompa „stand-by“ hyn ne funksion me renjen e presionin nen nje nivel te paracaktuar. Funksionet e saj jane te njejta me funksionet e pompes elektrike kryesore te sherbimit, por sherben si nje rezerve ne rast mosfunksionimi te pompes elektrike te sherbimit.

Ky grup presioni do te jete ne gjendje te furnizojte njekohesisht 4 hidrante DN25, per nje prurje prej 35l/min dhe nje presion ne dalje prej >0.2MPa ne perputhje me Vendimin VKM nr. 319, date 12.04.2017 per shkalle rreziku LH (Light Hazard).

1.2.3 Sasia e ujit

Sasia e ujit qe kerkohet eshte barabarte me kerkesat per uje te vazhdueshem per shuarjen e zjarrit si dhe kohen ne dispozicion qe duhet per eliminimin e tij. Kjo sasi percakton depoziten e nevojshme te ujit ne dispozicion per mbrojtjen nga zjarr per nje autonomi mbi 60minuta te impajntit MNZ (mbi 10.000 litra ne dispozicion te impjantit MKZ).

Rezervuari MNZ duhet te pajiset me tregues niveli elektronik si edhe mekanik vizual, te cilet duhet te sinjalizojne per renjen e nivelit te ujit ne rezervuar nen nje vlere te percaktuar. Ky sinjal duhet t'i transmetohet panelit qendror te komandimit te grupit te pompimit dhe nepermjet saj sinjalizuesve perkates. Perdoruesi duhet te garantoje edhe zevendesimit e here pas hershem te kesaj rezerve nepermjet perdorimit te saj per qellime sanitare.

1.2.4 Grupi i lidhjes me brigadat MKZ

Nga kolektori shperndares MNZ ne ambientin teknik eshte parashikuar edhe nje pike lidhjesh me brigadat e specializuara PNMZSH, te pajisura me dispozitivin perkates, ne afersi te hyrjes ne parkim. Lidhja do te perfshijne:

- no.1 dalje per lidhje UNI 70 ne perputhje me normen UNI 808, me diameter jo me te vogel se DN70, te mbrojtura nga futja e trupave te huaj ne to;
- no.1 valvol nderprerese e cila lejon nderhyrjen ne komponentet e saj pa qene e nevojshme te zbrazet impjanti;
- no.1 valvol moskthimi;
- no.1 valvol sigurie e taruar ne 1,2Mpa (12bar) per kontrollin e mbipresionit nga pompa.

Njekohesisht, ne cdo sheshpushim te te dy shkalleve te evakuimit eshte parashikuar edhe vendosja e nje valvole DN65 ("Landing Valve") per lidhjen e brigadave PNMZSH me rrjetin e hidranteve.

1.2.5 Fikesit portabel te zjarrit

Ne projekt jane percaktuar me saktesi edhe zonat qe kane lidhje me klasat e zjarrit si dhe vendet ku jane vendosur fikesit portabel te zjarrit.

Fikesit e zjarrit portabel me pluhur EN3 do te jene te klases 34A 233BC me karakteristika si me poshte:

Type	Cylinder's weight in[kg]	Cylinder's material	Extinguishing material weight in[kg]	Extinguishing material	Functioning in [sec]	Material through in [m]	Functioning under the temperatures [°C]	Dimensions		
								Height [mm]	Diam. [mm]	Thickness [mm]
EN3	8,0	Steel	5,0	Powder	20	5	-20/+60	500	150	1.6

Shuaresit e zjarrit portabel do te mirembahen dhe testohen te pakten ne cdo vit nga autoritete te licensuara per kete qellim.

Numri i fikesve te zjarrit eshte perzgjedhur ne te gjitha rastet me i larte se ai qe parashikon normative BS EN 3 dhe Udhezimi nr.425 date 24.7.2015.

Ne ambientet e kabines elektrike do te vendosen fikes zjarri me CO2. Karakteristikat e tyre do te jene si me poshte:

Type	Cylinder's weight in[kg]	Cylinder's material	Extinguishing material weight in[kg]	Extinguishing material	Functioning in [sec]	Material through in [m]	Functioning under the temperatures [°C]	Dimensions		
								Height [mm]	Diam. [mm]	Thickness [mm]
EN3	14.9	Steel	5,0	CO2	17.37	4	-20/+60	751	137	2.0

Fiksiti me CO₂ do te mirembahen dhe testohen cdo 6 muaj nga autoritete te licensuara per kete qellim.

1.3 PJESE E RELACIONIT TE PROJEKTIT ELEKTRIK TE MNZSH-SE

Projektimi, prezenca dhe mbajtja ne gadishmeri pune e sistemit elektrik, ndricimit te rrugeve te evakuimit dhe sinjalistika e evakuimit jane te nevojshme per t'u mos demtuar personat qe gjenden ne godina ne rast zjarri apo ne cdo lloj rasti emergjence, per te parandaluar panikun, per te mundesuar boshatisjen e godines dhe per te siguruar nje ambient te sigurte.

Per cdo pajisje elektrike eshte kusht qe te projektohet dhe te ofrohet ne perputhje me standartet dhe rregulloret e sistemeve te ndricimit te rrugeve te evakuimit, orientimit, ndricimit ne rastet emergjente, perceptimit te zjarrit dhe sistemit te paralajmerimit.

I gjithë projekti elektrik i ketij objekti do te zbatohet sipas normave teknike dhe ne perputhje me normat e mbrojtjes nga zjarri dhe shpetimit. Rrjeti elektrik, ndricimit dhe pajisjet qe perdoren ne kete objekt do te jene ne pershtatje me shkallen e rrezikut qe paraqet veprimtaria.

Instalimet elektrike do te realizohen në përputhje me të gjitha normat elektrike (DIN VDE, IEC, EN). Po kështu dhe materialet qe do të përdoren në objekt do të jenë në përputhje me këto norma.

Ndricimi ne Rastet Emergjente

Ndricimi i emergjences eshte parashikur per te dy katet e shteses; do te ndricohen gjithashtu vendet ku gjenden shkallet dhe koridoret e evakuimit, dhomat e shperndarjes elektrike dhe ambjenti teknik i stacionit te pompave. Sistemi i ndricimit ne raste emergjence do te rregullohet qe te ofroje ndricim te mjaftueshem duke hyre ne veprim automatikisht ne rastet kur nderpritet furnizimi me rryme nga rrjeti publik apo ndonje rrjet te ngjashem te jashtem, ne raste zjarri, termeti etj.

Ndricimi emergjent do te ofrohet brenda 2 oreve kur nderpritet ndricimi emergjent.

Elementet e ndricimit ne rruget e evakuimit do te vendosen ne tavane dhe niveli i ndricimit emergjent ne cdo pike platforme ku ecet do te jete minimalisht 1 lux. Ne fund te periudhes se punes emergjente niveli i ketij ndricimi ne cdo lloj pike nuk do te bjere ne nje nivel me te ulet se 0.5 lux.

Orientimi ne Rastet Emergjente:

Elementet e orientimit ne rastet emergjente do te jene te llojit qe ndizen vazhdimisht, edhe nese atyre iu nderpritet ndricimi normal ato do te vazhdojne te qendrojne ndezur edhe 2 ore te tjera minimalisht.

Tabelat e orientimeve do te jene me fushe te gjelbert dhe shkrim te bardhe, ne perputhje me standartet perkatese.

Distanca maksimale e shikuesmerise se nje shenje orientuese kushtezohet nga kerkesa qe kjo distanca te jete jo me e madhe se 200 fishi i lartesis se dimensionit te shenjës.

Ne rruget e evakuimit nuk do te gjendet asnje shenje tjetër me drite pervec atyre orientuese, ne menyre qe te mos krijohet asnje medyshje ne lidhje me drejtimin e largimit.

Shenjat orientuese do te jene te shikueshme neper rruget e largimit si ne kohe ndricimi normal si ne ndricim emergjent.

1.4 SKEMAT E EVAKUIMIT

Evakuimi vertikal nga godina e kopeshtit/cerdhes realizohet nga tre drejtime: nepermjet shkalles qendrore si dhe nepermjet dy shkalleve te emergjences te vendosura ne drejtime te kunderta me njera tjetren.

Po keshtu edhe largimi nga vete objekti ne katin perdhe realizohet nepermjet tre dyerve te evakuimit.

Ne kete menyre, distanca me e madhe e largimit te emergjences rezulton me e vogel se 25m.

Ekspert MNZSH

Ing. Artan DERSHA Lic. no. M0229/3 Cert. No. 2711